

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8SH-1
N 42

ISUF NELAJ

Ditët tona


VJERSHA DHE POEMA

8JH-1
N41.

ISUF NELAJ

DITËT TONA

vjersha dhe poema



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»

N G A L L I M

Pranvera zbardhi blerimin në pemëtore
e ngjiti në tarraca dhe në mal,
pastaj ngallim u dha, të lidhin kokërr
grunjat e të lashtat si deti valë-valë.

Do të bëhet ashtu si thotë kënga
«bereqeti porsi rëra e detit»,
sikur flasin kështu kallinjtë plot bukë
e bujqërve ëmbël u buzëqeshin.

Si parcelë e grurit dhe fushë e poezisë.
Si bujqër poetët e rrëmojnë shumë
që të gjitha vargjet të kenë poezi
të jenë si kallinjtë plot bukë.

Nëse në parcelën e vjershës sime
nuk kanë ngalluar ende vargjet,
do të thotë se e kam punuar cekët
si duhet nga barishtet s'e kam harrur.

D I T È E G È Z U A R

(fragment)

Kjo ditë më e madhja, më e gëzuara ndër ditët,
gëzimin e festave ka mbledhur.

— Struku mikroborgjez,
që në vesh më pëshpërit:

«Shpëtove, e mbarove stazhin,
tani në brigadën tonë normist do të vish».

Jashtë qenies sime të mbeten,
si para një porte të hekurt,
konceptet: punë e lehtë në drejtim, privilegje.
Struku mikroborgjez, ti që kërkon të hapësh
mes meje e shokëve,
hendeqe largësish.

Hesht!

Përsëri në brigadën ku jam.
Interesi personal — një pikë ujë,
interesi i përgjithshëm — oqean!

Kjo ditë, më e gëzuara,
gjurmë e thellë në jetë.
Emri i ri m'u dha: Komunist,
një emër që dejet i shtrin nga madhësia e trupit
gjer në çdo qelizë të atdheut tim.
Vështrimit m'i jep madhësinë e globit,
mendimit thellësinë e detit...

Të vështroj me syrin e Partisë.
Në këtë ditë dil dhe tako ditët e nesërme
matu pulsin, ritmin, hapin....
Komunist-detyrë e re.
Puna model para shokëve.
Para syve të mos më shpëtoj qoftë dhe një kalli
gruri,
veshokët t'u heqë nga sytë indiferentëve.
Të mos ulet në qerpikë asnje minutë
pesha e rehatisë,
të mos bjerë në mendimin e pastër asnje izmë.

S'do ta kryeja detyrën
qoftë dhe një çast,
sikur armiku i klasës mjegull miopie të më hedhë,
nëse në poligonin e qitjes
predhat s'do t'i futja të tëra në tabelë.

* * *

Komunist u bëra.

I pari në majën e sakrificave,
i fundit të ulem në stolin e pushimit.

Në rast alarmi
në front do të vete i pari.

Mësimet e Partisë si busull gjithnjë do të mbaj
përpara.

* * *

S'mjafton biografia e prindërve,
djersa ime gjer tani.

Ditët e sotme para shtrijnë
ditët e ardhme
për të vënë në reliefin e kësaj autobiografie,
lartësi digash, kodra e male të tarracuara,
fusha të dranazhuara
e maja sakrificash të kapërcyera,
për të vënë ende net të përgjysmuara,
ende brazda të hapura në pjerrësinë e kodrave.
Cilësitë e mia ende në kudhrën e kalitjes.

K O D R A T E G R U R I T

Mbi supet e shoqeve që punojnë me autokombajnë
derdhet peisazhi i verdhë,
mbi supet e tyre si mbi kreshta
derdhet dielli i nxehthë.

Dita më shumë se kurrë zgjatet,
Në lëmë shkarkohen rimorkio gruri.
Në lëmë, pranë depove,
një relief i tërë me kodra prej gruri.

Peisazh i verdhë po ngrihet shpejt
nga duart e fuqishme të punëtorëve,
sa më shpejt t'u lirojë vendin
e fushën t'ua dorëzojë hamulloreve.

URA E RE MBI LUMIN DRIN

Me syrin e malësorit që zbut nga Gjalica
e shoh këtë urë gjigante:

— Bre ... Bota duhet të çuditet
me një urë kaq të lartë që lidh male.

Me syrin e një të riu në punë këtu
e shoh, urës së Bushtricës ia kalon
e sa e vogël do të na duket nesër
para veprave gjigante që do të ndërtojmë.

Me syrin e një fëmije e pashë,
si një ylber i bardhë zgjatur,
njërin krahas në malin e Mamzit
tjetri në qytetin e ri,
në këmbët e Gjalicës kokëzbardhur.

Me syrin e poetit e shoh këtë urë,
imazh i perspektivës para më del
lartësi e saj humbet në ujë,
buzët afron ta puth një liqen.

Do të bashkohen djersët e punëtorëve këtu
me ato në gjigantin e Fierzës,
si një shirit inaugurimi në hyrjen e liqenit
 kjo urë,
si një leitmotiv i bukur i poemës.

F O R C A J O N È

*Nga puna për hapjen e kanalit që
do të mbush rezervuarin e Priskës.*

Dhe nëpër shkëmb e pyll
forca jonë çan kanalin,
ujin e malit e djersën
ia falëm rezervuarit.

Rezervuari si nikoqir
le të mbledhë rrjedhjet, pikat,
por në verë kaq bujar
të blerojë kodrinat.

Rezervuari në fyt
le t'i hidhet thatësirës,
jo, s'do ta lemë para kohe
t'i sjellë vyshkjen bimës.

Dhe nëpër shkëmb e pyll
po çajmë kanalin,
gëzimi i syve do të qeshë
në pasqyrë rezervuari.

ME BUZËQESHJEN E FUSHËS

— *M. Buzalit, traktoriste në NB Kamenëz,
Heroinë e Punës Socialiste —*

Këto ditë kthehet vonë në shtëpi.
Gjithë ditën me traktor çan brazda,
mbi to hedhin farën mbjellëset,
në vijat e ballit i rrjedh djersa.

Në ditët e fushatës së mbjelljeve,
muzgu në kthim i fshin ballin e vogël,
futet në shtëpi me buzëqeshjen e fushës,
me aromën e këndshme të vlagës së tokës.

Pesha e shtëpisë këto ditë më shumë
ka rënduar tek fëmijët, tek i shoqi,
se duhet psonisur, duhet bërë gjella,
duhet mbajtur pastër shtëpia dhe oborri.

Ajo vjen e sjell të dhënrat e pasura,
u sjell fëmijëve të rejat e ditës.
E ata i vënë në fletoret e detyrave,
nëpër fjali e probleme të aritmetikës.

Këto ditë kthehet vonë në shtëpi,
në dhomë të saj bie nata e lodhshme,
nën kokë jasteku prej kadifeje i parcelave
dhe dielli që mbi mal më herët do të çohet,

1975

KOMISARI NË SHTËPINË TONË

Atë mbrëmje në shtëpinë tonë erdhi komisari
me dy partizanë.

Zjarr tē madh u bëmë me nënën.

Ngrohej komisari në zjarrin tonë pranë oxhakut,
ngroheshim ne në zjarrin e fjalëve tē komisarit,
ngrohesha nën krahët e ngrohtë tē dy partizanëve.

Në hartën që mbante komisari përpara
vështronim,
me lulëkuqe e vjollca
sikur mbushej kopshti ynë plot.

Atë mbrëmje në shtëpinë tonë komisari,
me fjalët e ngrohta,
mbushi dhembjen për vrasjen e babait,

mbylli brengat e derteve e hallev,
mbylli plagët e urisë,
mbushi plot hambarët.

Atë mbrëmje, si asnjëherë, fjetëm të ngopur
po me revoltën ndaj armiqve më shumë të arma-
tosur.

1975


KUR KTHEHEN NGA PUNA

Ruga mes fermës
si një tunel i blertë.
Dita e lodhur ikën,
muzg i mbrëmjes vjen.

Kalon ngadalë çifti i ri
që po kthehet nga puna,
muzgu s'ka pse t'i mbrojë
nga vështrimet e sëmura.

Lopatat e gjata në krah
sa bukur u rrinë!
Muzgun e mbrëmjes që ra
si tokë e butë e grijnë.

Biseda e ngrohtë
heq lodhjen e ditës,
plepat u shtrijnë krahët
mbi supe si prindër.



KUR ERDHA PËR HERË TË PARË NË TIRANË

Kur erdha nga malësitë e Kukësit
reliev i ashpër i vendlindjes sikur zbriti;
kodrat të vogla,
fushat të gjera,
Dajti si trungu i Gjalicës.

Rruja e asfaltuar, e gjerë,
sahati që nga larg kokën zgjaste.
Pallatet e gëzuar nga dy anët e rrugës
sikur na uronin mirëseardhjen.

Sa shumë autobusa urbanë
vinin nga fabrikat, mbushur plot
kthehen pranë fëmijëve, kthehen për t'u çlodhur.
Mirëmbrëma qytet i madh punëtor!

Mirëseardhjen më uron qyteti me buzëqeshjen e
pemëve,
të dritave, të vitrinave plot,

pallatet e rinj që me respekt shpinën s'i kthekan
malit.

Mirë se ardhe! thonë këngët e ngrohta të
Fitnete Rexhës
e ritmet e këndshme të valles së Shupalit.

Sa shumë pllaka mermeri në gjoks të shtëpive,
të rrugëve,

gjurma të së kaluarës së lavdishme,
sa shumë gjelbërim, lulëzim i dritave.

Blerimi si në kornizë ka futur rrugët,
bredhat e pishat e malësisë paskan zbritur në
parqe,

Tiranë e kuqe, Tiranë e blertë, e madhe.

KU E LATË DITËN E PUNËS

Në linjën e autobusit fshat-qytet

Ej...

Ku shkoni?

Sa zëra ju ndoqën pas si shigjetë,
kurse ju me vrap u futët në autobus
me nga një shportë vezë.

Vezë të freskëta të pulave,
ditë të humbura.

Ju ndoqën me sy bashkëfshatarët
dhe rrezet e diellit.

Sa e gjerë toka ku mbillet gruri,
sa e ngushtë qoshja ku strukeni
në fund të autobusit.

Dy shokë, dy shporta vezë,
dy forca pune mangut për të mbjellë.

Rrëshqet autobusi,
vështrimet, fjalët e pasagjerëve:
ju hidhni sytë majtas, o dembelë,
majtas është Kombinati i shpendëve.

Vezët zbardhojnë dyqaneve plot,
vezë nga privatët kush kërkon?

Dhe pse në fund zutë vend,
të ngroheni me pronën e vogël;
s'jua përtojnë gjatë gjithë rrugës
t'ju kërkojnë llogari dhe pasagjerët:

Ku e latë ditën e punës?

PO TË PRET KY FSHAT

*Një shoqëje nga Tirana që u martua
në fshat.*

Po del,

sytë e ndritshëm si ky qytet
me kodrat plot vreshta si vetull,
gjithë rrugët si krahët e tërë qytetarëve
të zgjaten shpatullave
për të të përshëndetur.

Po të pret ky fshat,
ky fshat
dikur shkurre e ferra,
sot me kodrat plot rrush
si gjoks i fryrë
që paska këtu vjeshta.

Kodrinat me vreshta të fshatit të dhëndrit
blerim i këndshëm mbi supe,
pranvera e vjeshta zihen mes tyre
se kujt i ngjet prej tyre
kjo nuse?

Si kultivuese vreshti do punojë në brigadë
pas martesës,
si të kalojë një javë,
me vështirësitë, me kapriçot e natyrës
do të ndeshet
çdo ditë me bel e me shatë.

NDESHJE ME NJË NEGLIZHENT NË PUNE

Si e lëshove vijën e ujit
mes parcelës së misrit
e nën ombrellën e plepit
vete e shtrihesh?

Dhe ngrihesh çdo mëngjes
«Më ka inat brigadier,
s'më vlerëson punën si duhet.
Ç'burokrat që kemi!».

Në këtë parcelë
ec uji kot së koti,
po ndërgjegjja jote
në guaskë gjoksi.

— Ç'po bën kështu? —
zëri brigadierit — furtunë,
fjalët e ashpra si grusht
mbi ndërgjegjen e sëmurë.

PËRPARA NË SULM!

Dëshmorit Sadik Buzos, *ish-koman-dant bat. I, Brig. VI S.*

Ajo thirrje mbeti e incizuar në kujtesën e viteve,
e ndjeva dhe sot në stërvitje, si në luftë të vërtetë,
atë zë përzier me zërin e komandantit tim
tek thërriste: Përpara!...

E ndjeva nëpër breshëritë e predhave,
duke çarë si predhë mes blokut të pengesave.

Ku pyet shkëmbi për rrjedhën e burimit,
ku pyeste gjoksi për plagët.

Plaga rridhte gjak,
automatiku breshëri.

Zërin tënd — Përpara — jehonin malet.

Sa keq të erdhi që u ule e s'pate fuqi
 të ngrihesh më,
i dashur komandant,

por përsëri i gëzuar,
se automatiku yt breshëritë vazhdonte
e batalioni përpara mbi armikun
mësynte.

Kanë kaluar tridhjetë vjetë
dhe gjaku yt pikon
ende i ngrohtë
ndër këngët
e në kujtimet tonë,
gjurmët e heroizmit të forta gjithnjë,
s'u shua zëri yt,
e ndiej të përzier me zërin
e komandantëve të mi.
Përpara!

NË SYTË E VULLNETARES MIRË

Në sytë e vullnetares Mirë
maja e zbardhur mbi Shkëlzen,
duke e ulur të puthë malin e Thanës,
kësula e bardhë i bie në liqen.

Në sytë e saj dita e afërt,
kur treni do të shkojë në Gur të Kuq.
me vagonat e mbushura me mineral të pasur,
me gazin e zemrave do ta mbushë.

Në sytë e saj sa shumë dritë,
valët e bucura të detit në Durrës,
krahu i hekurt i shinave i afron
valët e liqenit të puthë.

D Y L U M E N J

Dy lumenj zbresin nga Prrenjası,
njeri i kaltër tjetri i hekurt.

Megjithëse nganjëherë mali i ndan,
bri më bri ecin si vëllezër.

Njëri me ujë na ushqen bimët,
vrapon të përqafojë fushën,
t'i largojë thatësirën e verës,
t'i freskojë gushën.

Tjetri i hekurt vrapon
ngarkuar me hekur-nikel,
vrapon drejt kombinatit,
industrinë të ushqejë.

Dy lumenj ecin ngarkuar
njeri me drithë tjetri me hekur.
Dora jonë i bëri kaq të vlefshëm,
i bashkoi si dy vëllezër.

S Y R I I N È N È S

*Pse e lini ȝezm  n hapur? — na foli
nj   n  n   n   Koplik.*

Aty uj  t v  rshon n   kanalin vadit  s,
n  p  r ȝezma fryn flladi i bjeshk  ve,
q   t   fshijn   lodhjen me st  rkalat n   gryk  
apo n   fyttyr  n e djegur nga dielli.

Uj   ka plot, po n   syt   e saj i del
ndoshta imazh i pusit t   at  hersh  m,
pusi q   thellohej e mbetej pa nj   sy, i p  rlotur,
e n  na litar  t shtonte nj  ri pas tjetrit.

Syri i n  n  s e ndiqte me ankth
at   sy t   p  rlotur q   i largohej,
e prekte thell   n   zem  r z  ri i f  mij  s
q   buz  t me uj   s'kishte t'ia njomte.

Si saç binte korriku e gushti,
mbyllej dhe ai sy me qerpikun e tmerrit,
nëna vraponte me orë nëpër lugina, në puse të
largët,
të sillte në mbrëmje me ujë përgjysmë bucelën.

Në sytë e saj kanë mbetur ende puset e thellë,
në duart e saj vijat e gërryera si në gurin e pusit,
ndaj zemërohet shumë kur dikush çezmën
hapur e le,
apo kur ndonjë fëmijë loz me ujin.

MOTIVE NGA KËMISHTAJ

1. P O R T R E T I Y T

Këmishtaj,
portretin tënd s'e shoh më
rrethuar me korniza kallamash
në pasqyra të mëdha moçalishtesh,
me trupin anemik të gërryer nga malarja,
të munduar nga shtypja,
me trupin e veshur me këmishën e arnuar,
me lëkurën e kömbëve si opinga.

Portretin tënd
nën diell të ngrohtë
me këmishën e re veshur,
me këmishën si fushat tuaja,
që të rri aq bukur
në trupin e shëndetshëm.

Portretin tënd e shoh
gjithnjë në shkallët e ngjitjes,
Këmishtaj-sinonim i fjalës ngjitje.

2. MBRËMJE NË KËMISHTAJ

Yje në qiell.

yje dritat e traktorëve në fushë,
drita elektrike rrugëve,
drita gëzimi në sytë e njerëzve.

Lëvizje të shpejta.

Fragmentet e bisedave në çdo vend
si frute të pjekura.

— Natën e mirë!

Përshëndetja e shoqeve me bicikletë
që kthehen vonë nga vjelja e pambukut.

Bisedat ziejnë

«Mbjelljet sivjet po i përfundojmë në kushte më
të mira,
fjala e dhënë duhet mbajtur
dhe ekonomitë e tjera në rrugët e rritjes së
prodhimit
hapin kanë zgjatur..»

Drita në arë, në rrugë, në zyra.
Në zyrën e kryetares plani i betejës përpara,
ndërmjet kuadrove e specialistëve tendosen fijet
e përgjegjësisë,
shqetësimi dhe për një litër qumësht pa
mjjelë,
dhe për një bohçe pambuk lënë në ara.

Dy të rinj vrapojnë duke çarë muzgun,
televizori jepka program për bujqësinë.
Dhe lajmet duhen dëgjuar,
Shlëzingeri fonde lufte kërkoi përsëri.

Po muzgu mbi drita, mbi tyta armësh griset,
dhe gratë kthehen nga qitja me rezultatin
«shkëlqyeshëm».

Por ka dhe të meta dita.
C'paska muzgu, pse skuqka kaq shumë
fytyrën e xha Kolit?
A, lopët i paskan shpëtuar gabimisht
në parcelën e jonxhës.

Dritat ndezin mbrëmjen e bukur.
Ja, nata vjen e fshin lodhjen e ditës,
në botën e shqetësuar të gjithëseicilit
dita e nesërme më e madhe do të gdihet.

Këmishtaj 1975.

3. — DY RREPE MES FSHATIT¹⁾

Vetëm pas ca ditësh, ja, mes fshatit,
me lartësitë me çerdhet e lejlekëve,
karakteristikë e lashtë e fshatit,
më tërhoqi vëmendjen.

S'e nisa këtu kronologjinë,
me ju së pari në bisedë të isha shtruar,
si me dy pleq dëshmitarë të historisë,
për të djeshmen e të sotmen pér të biseduar.

S'e nisa me ju kronologjinë,
o rrepe me rrudha shekujsh,
strumbullar i gjithë peisazhit,
copëtuar me lot pellgjesh.

Tjetër lartësi kishte shqetësuar poezinë,
lartësi e punës, e mendjes së njerëzve,
që kishin qëndisur këtë mozaik peisazhi,
duke ju mbartur vetëm ju nga peisazhi i vjetër.

1) Mes fshatit Këmishtaj ndodhen dy rrepe të mëdhenj.

Dhe banorët e tu, lejlekët, tanë në fund i pashë,
në çerdhet e tyre shkonin e vinin,
dhe ata në çerdhet e ngrohta
me sqep peisazhin e ri sillnin.

Tjetër lartësi më shqetësoi mua sot,
lartësi e ndërgjegjes së kooperativistëve.

4. KOPERATIVISTET E KËMISHTAJT

Sot ato të pranishme u bënë
në çdo kooperativë e në çdo kolektiv,
ku diskutohet qoftë dhe për një pëllëmbë
e për një misër të pambirë.

Nëpër parcela, por dhe në shtëpi
ato nëna të fëmijëve, nëna të bimëve,
me aromën e fushës e të bukës hyjnë
si shqetësim i mirë në çdo familje.

Të pranishme u bënë në vargjet e poetëve,
ato me botën e madhe të pastër,
~~kur kthyen rrjedhat e lumenjve,~~
~~kur thyen vapën e acaret.~~

Portreti i tyre është më i thjeshti,
nuk kanë krehrin e hënës në flokë,
përparsen e fushës e kanë për mesi,
shaminë me flokëza pambuku në kokë.

Të pranishme u bënë dhe në uzinë,
grafikët e planit gjithnjë në ngjitje.
Fabrikë pa çati nuk është bujqësia,
kur ngrohet me dashurinë e të gjithëve.

1975.

5. MIKPRITJE

Në shtëpinë e kooperativistit Vangjel Mile, ish-fshatar i varfër.

Dhe në shtëpinë e xha Vangjos
gjeje Myzeqenë mikpritëse,
jo në rrogoz në kasollen e ulët,
po në shtëpi të re me mobilje.

Fushat ulën bollëkun në tryezë,
gotat e urimit mbushur plot.
S'mban mend ajo ndonjëherë
të vijnë miq nga çdo anë si sot.

Këmishtaj pret mysafirë nga çdo anë,
ajo jep, por dhe merr përvojë.
Në çdo shtëpi s'është e çuditshme
me shkencën bujqësore të të njohë.

Dhe s'pushoi biseda e ngrohtë
gjer vonë dhe nga pjesëtarët e familjes,
si gjithë ajo lodhje e ditës
sonte s'i mposhtka dot qerpikët!

1975

6. NË SYTË E TIJ

*Duke biseduar me një kooperativist
të vjetër në Këmishtaj.*

«Eh, si kemi jetuar
në atë kohë të rëndë!
Shtypja e beut, malarja,
kurrë s'na u ndanë.»

Në sytë e tij sikur pashë
jetën mbledhur kruspull,
në një kasolle pa oxhak
plot tym të mbushur.

«Partia na rilindi,
na fali jetën,
kudo shtëpi me oxhak
e fëmijë të shëndetshëm.»

Pashë në sytë e tij
kaq shumë ndryshime!
Atë që s'e bënë dje shekujt,
sot e bëjnë vitet.

Me sytë e tij të ndritur
qesh Myzeqeja —
piedestal prej drithi
për ditët e reja.

T R A K T I

Ai çante si një fokus drite mugullimën e viteve,
ai çante me gjoks të përgjakur dhe hekurat e
burgjeve.

pranë të uriturve — rrugën për te buka,
pranë punëtorëve — rrugën për te puna,

pranë të munduarve — rrugën te drita,
pranë të vuajturve — rrugën te liria.

Në atë trakt — dallgë të përplasura dëshpërimi,
në atë trakt — buzëqeshja e afërt e agimit.

Ai trakt me shkronja të përgjakura
në hundë të armiqve — bomba të plasura.

Ai trakt — zëri i partisë në shtëpitë e të varfërve
në ato ditë e net ilegale.

GISHTI I PRERË

*Në fshatin tim ballistët i prenë
gishtin një gruaje, pse nuk pranoi
t'u shtronte për të ngrënë e për të
pirë.*

Gishtin tregues duke i prerë deshën ta nënshtronin,
por i gjakosur dhe më prerë
ai shoqëroi fjalët si një shpërthim revolte:
— Jo, -s'i gostitim ne armiqëtë!
Dhe petalet e bardha të kumbullës në oborr u
 skuqën
dhe revoltën e gjithë fshatit në këmbë e ngriti.

*

*

*

Gishtin e prerë vitet si fasho e mbyllën,
por dhembjen ndjeu nëna, gjatë atyre ditëve,
kur kulaku punonte kundër pushtetit në fshat,
me dhëmbët e ujkut kafshonte pronën kolektive.

* * *

Jo, s'keni vend kötu,
armiqve, o nënë, ti gjithnjë u the;
mbi ta fjala jote si plumb,
në këmbëzën e armës së gatishmërisë gjithnjë
dhe gishti yt i prerë.

FUSHAT E BETEJËS MBAN MBI SHPINË

Topollogaritësi vrapin e ka të gjatë
kodrat kaq të dashura e presin me gjoksin e hapur
 të transheve,
në plashetën e tij koordinatat, pozicionet,
 objektivat,
në plashetën e tij fusha e betejës.

Nëpër saktësinë e shifrave llogaritjet
lëvizin komandat, lëvizin tytat e topave,
 predhat të tëra në objektiv,
në gjoksin e topollogaritësit nënshkruajnë gëzimin
 e fitores.

Lodhjen e fshin me nurin gazmor të fytyrës,
nga një pikëvrojtimi në tjetrën çan me shpejtësi,
peshë e plashetës e rëndë,
peshë e plashetës e lehtë
se fushat e betejës mban mbi shpinë.

LAHE REXHEPJA

*Lahe Rexhepja një vajzë për seri¹
i muer mauzeren njaj asqeri.*

Populli

Ku je vajzë, ku je, burrneshë,
trupi yt takon në bjeshkë.
Armë nuk kishe, kur në luftë dole,
pyesin malet ku e more?

Lahe, Lahe, moj burrneshë,
vret armikun me armë të vët,
luftën ta dëgjuan malet,
me trimëri jeta të matet.

E këtu mes nesh, të kemi
Lahe trime jo vajzë për seri.

1976.

1) e çuditshme

H A P E V A L L E N

*Hape vallen, mos e mbyll,
moj xhane, mos e mbyll!
myzeqare*

Hape vallen, myzeqare,
të hyjnë gjithë shoqet.
Shihi si u ndrisin krahët
si shpata në ballë shqote.

Le të hyjnë shokë plot,
punës vrull i japid,
por ashtu në valle sot
dinë ta hedhin hapin.

Hape vallen, mos e mbyll,
Myzeqeja po hedh valle.
Këmishat zbardhin si dritë,
sikur kanë zbritur Alpet.

Hape vallen, ja, po vijnë
vjelëset me gonxhet e bardha,
miqtë nga zemra e malësisë
lodhjen korrin mbi tarraca.

Hapni vallen! Sa u futën!
Ç'miq që paske, Myzeqe!
Dridhe, moj, dridhe, shaminë
porsi shkumë e valëve.

BIJË E TRAGJASIT, MOJ ZONJË

Bijë e Tragjasit, moj Zonjë,
të kujtojnë moshatarët,
në gjoks të ndiejnë supin e ngrohtë
e në mes të ndiejnë krahët.

Bijë e Tragjasit, moj Zonjë,
të kujtojnë në Tragjas.
Emri yt në Dukagjin,
emri yt në Lis, në Mat.

Emri yt, moj Zonja Çurre,
vetëtimë përmbi re,
vija gjaku mbi dëborë,
rreze drite mbi atdhe.

Dhe tani, kur mbi makinë
bustin tënd sjellim në fshat,
ngjan sikur afrojmë supet,
malet majën më të lartë.

1976.

MIC SOKOLI

Mic Sokoli, nise rrugën,
ballë pér ballë t'u dalësh turqve
dhe t'i grish me jatagana,
éshëtë urimi që të jep nëna.
Nëna jote bukë s'ka
por Turqissë në gjunj s'i ra!

Mic Sokoli, merr urimin,
merre prej nënës bekimin.
Mbi maja malesh vetëtima,
mbi maja shpatash liria.
Zemra jote kaq e madhe,
sa atdheu plot me halle.

Mic Sokoli, para turqve
ball pér ballë, por s'u tunde.
Nisën të gjuajnë me topa,
gjoksi — shkëmb si malet tonë.
Topi kris, gjëmon plot zhurmë,
gjoksi yt ka zjarr më shumë!

Si kreshtë mali re mbi top,
Cermaleva ç'pat që u drodh?
Shtrive duart, fort u kape,
zjarr e gjëmë topit ia ndale.
Krahët ku shfryu stuhia,
mbetën shtrirë nga liria.

Gjoksin tënd s'e shpuan predhat,
nuk e shpuan dot shigjetat.
Sepse malit ç'mund t'i bëjnë,
drejt nga ta, mbrapsht prapë ua kthen.
Mic Sokoli rrugën çele
të çajmë krepa e zabele!

VJELËSET E PAMBUKUT

*Fletësh nëpër boçë,
flutur përmbi fletë
e para ndër shoqë
dole ti sivjet.*

Populli.

Sa të shpejta duart
duke vjelë pambuk!
Gonxhe e bardhë në duar,
gonxhe nëpër buzë.

Fusha bën çudi,
në peisazh të bardhë,
këto duar mbledhin
shpejt si me kombajnë.

Era u ka zili,
mos flutura jeni,
të parat ia nisni
të fundit ktheheni.

Në duar pambuku
basmat e pëlurat,
zemrës bardhësi
parcelash të bukura.

Sa të shpejta duart
që vjelin pambuk!
Gonxhe e bardhë në duar,
gonxhe nëpër buzë.

1976.

TEKSTILISTET E KOMBINATIT «MAO CE DUN»

Tekstilistet lulet e fushës,
trendafilat e qytetit tonë,
diellin dhe buzëqeshjen
venë në basmat që prodhojnë.

Berati i bukur në mbrëmje
si kala dritash ngritur,
bardhësi e buzëqeshje
tekstilistesh ballëndritur.

Beratit t'bukur me lule
i qesh dielli përmbi Tomor,
Beratin me shkallë dritaresh
kombinati e zbuluron.

PEISAZH DIMRI NË FERMË

Tokat e gjera si det i bardhë,
parcelat e serave si ishull pranvere
blerojnë
mbi dimrin
si sfidë e tmerrshme.

O shokë punëtorë të serave,
duart tuaja lëvizin stinët;
dimri u vërsul me grushtet e breshërit,
me gjoksin e stuhive,

por brenda tyre pranvera
shtrihet me gjelbërimin e bimëve.

SHEFI I RI NGA KLASA

Iku ish-shefi
«Do të më kërkojnë, — tha, — e di!»
Këtë mendim e hodhi si fara
pa asnje fuqi.

Erdhi shefi i ri,
shefi nga klasa,
erë e freskët po fryn,
erë e fushave, e stallave.

Iku ish-shefi,
që gjoksin e rrahu me grushte
kaq shumë para nesh, deprorëve,
e kaq shumë e uli para eprorëve.

Shefit të ri,
ardhur nga prodhimi,
gjoksin ia paskan rrahur erërat,
ballin e rrudhur mendimi.

Iku ish-shefi.
... Bosh tavolina, sa pak shkresa.
Në telefon vika zëri nga arat:
— Ç'u bë për farën, ç'u bë për plehrat?

Sa e gjërë zyra
e shefit të ri nga klasa,
zyra e tij sikur nxëka
tërë madhësinë e arave.

S'SHUHET DASHURIA

Ç'pati kjo mbrëmje kaq e gëzuar,
vajza në kabinën e tij përsëri
si atë mbrëmje kur po kthehej nga puna,
ku dashuria si eshkë zemrat ua ndezi me një xixë.

Po vij te ti, shoku im traktorist,
dita dhe nata le të buçasë.
Nëse dashuria për atë vajzë qe trëndafil i tharë,
le ta përmbyss plugu në këtë brazdë.

Po mbi dashurinë tuaj s'arriti kush të verë dorë,
i lumtë asaj vajze të gjithë thanë,
djalit nga qyteti ia numëroi konceptet një më një
e pastaj dhe prindërve e komshinjve të saj.

KRITIKË E RREPTË NË BRIGADËN E BLEGTORISË

Grafiku i qumështit ra pak sonte,
grafiku i rrahjeve të zemrës u ngrit,
frymë e rehatisë u fshi dhe nga skutat,
mjelëset vërshuan si askurrë me kritikë.

Furnizuesi e kishte vonuar ushqimin,
brigadieri ish treguar neglizhent,
fjalët e rrepta ua përplasën fytyrës,
llogari kërkohet nga punëtorët e thjeshtë.

— Si i lejuat vetes të vononit ushqimin,
barin, jonxhën e latë buzë rrugës!
Lopët me orë nga dritarja prisin
vetëm me sy kullosnin fushën.

* * *

Kritikë e rreptë në brigatën e blegtorisë,
mjelëset ashpër sot folën,
se s'të fal populli, s'të falin fëmijët
mangut në dyqan të çosh bidonat.

DUKE SHFLETUAR FLETËT E TOKËS

Punon shoku i ardhur nga dikasteri
së bashku me punëtorët me bel në arë.
Sa mirë beli shfletoka plisat e tokës
si shkresat e zyrës palë-palë.

Me shokun e tij punëtor ndërron një cigar,
me njëri-tjetrin vazhdon biseda,
punëtorët nga praktika i jepin shumë,
ai nga librat — njoħuri tē reja.

Në punë bashkë me punëtorët punon.
Duhet tē shfletosh dhe dokumente e shkresa,
sa kënaqësi kur me bel shfleton
fletët e tokës për t'i shkruar me tē mbjella.

P R I N D È R I T

Jeta e nënës në litar të kohës qe dënuar.

Litarët në kurriz me peshën e miellit,
me peshën e druve në kurriz,
me peshën e plehut për të plehruar arën,
me peshën e trupit tim.

Në ballin e babait plot rrudha
sikur janë fiksuar rrugët,
diku të bashkuara, diku të shpërndara,
rrugët ku u end për një copë bukë.

Halle në kurriz,
një jetë e tërë ngarkuar me ato rrugë,
një jetë e tërë plot luftë.

Në ballin e tij plot rrudha
rrugë monopate të kryqëzuara,
rrugë monopate të kaluara me shpejtësi
për t'i dalë armikut në pritë,
rrugë të përgjakura në ballin e tij,
rrugë të ndritura në ballin e tij.

AI MBET NË PËRJETËSI

*Heroit të Punës Socialiste Ylli Zajmi,
që dha jetën për të shpëtuar pronën
e përbashkët*

Mbet ai në përjetësi,
mbet në thellësinë e këngës,
buzëqesh jeta e tij në rritjen e tufës së
bagëtive,
në rritjen e pronës së përbashkët.

Sa herë vijmë në këtë vend
rrjedhin ujërat, forcën ndalin,
blegërijnë tufat e rritura të dhive,
me dhemshuri kërkojnë çobanin.

SHPATULLAT TË VURI MALËSIA TE KËMBËT

*Gjelosh Ramës i cili u var nga agjen-
tët e Zogut, pse nuk tregoi ku stre-
hohej B. Curri.*

Një lak prej litarit të hidhërimit
ka mbetur varur në atë lis,
ai lak që të vunë tradhtarët,
o trim, në grykë.

E deshe trimin e Shqipërisë,
nuk e dhe,
se atdheu për të kishte nevojë,
se ai ishte një me tokën e ashpër shqiptare,
ish mal me kësulën e Alpeve në kokë.

S'e tregove, se në zemër e kishe trimin,
trim dhe ti, o Gjelosh Ramë,
jetën tënde për shpëtimin e tij
e quaje pâk.

Por s'qe pak vepra jote,
dashuria për popull e atdhe,
ndaj mbeti ai lak në kujtesa,
i gjallë mbete, o trim, ndër ne.

SHPATULLAT TË VURI MALËSIA

*

* * *

Ej, s'ishte lehtë që ai lak litari
të të zhdukte ty.
Shpatullat të vuri malësia te kömbët
e të ngriti në pavdekësi.

1973.

Shpatullat e vuri malësia te kömbët
e të ngriti në pavdekësi
1973.

Shpatullat e vuri malësia te kömbët
e të ngriti në pavdekësi
1973.

PO UNË S'E MERITOJ KRITIKËN?

Traktoristi harroi plugun buzë kanalit dikush e pa, po heshti.

S'po punon ai plug tani parcelën,
për riparim ndodhet në ofiçinë,
plori i tij plugon në ndërgjegjje,
plori i tij çan gjumin tim.

«Ç'më duhet mua!» kjo shprehje
ndryshk i zi në ndërgjegjje,
ndryshk dhe në trupin e tij
buzë asaj parcele.

Por të tjerët s'qenë indiferentë
e çuan në ofiçinë për riparim,
ndryshkun e tij po e fshin
ndërgjegjja e tyre plot shkëlqim.

Nga oficina do të dal i pastër plugu
dhe traktoristin do ta shkund mirë kolektivi,
po unë me rrënë më duhet ta shkul
nga ndërgjegjja këtë ulçer indiferentizmi.

ngjyfshen i tash bë o mësuesi që
dëshmoj i kurrë përshtatje shqiptare
Të erdhën mendt tani, më në fund,
jemi kurrë mësuesi.

TË ERDHËN MENDT TANI MË NË FUND? . . .

*Një babai të penduar, i cili shkon te
miku të prishi fejesën e vajzës, bërë
me shkuesi.*

Luginës këmbët nuk di ku i shkelin,
lumi i gjatë anash si litar i bien,
degët e shelgjeve fytyrës i sjellin,
djersa si përrenj rrudhave i rrjedh.

I del kokë e shkesit si e nepërkës
në mendimet e tij që e mundojnë,
dyzet mijë lekët prek në xhepin e xhaketës,
fletët e lisave shuplakës i ngjasojnë.

Shtëpi e mikut më larg se asnjëherë
si pikë e bardhë shquhet në muzg,
me fëshfërima era, i duket se i flet:
— Të erdhën mendt tani, më në fund? . . .

Një gjerrë si njëkuq si këtuq nuk është ja
mëllë o fëmijët e tij. Një vjet janë që
dëshprave si përfshira le të vijnë së pari
zëdhënësimin. Shqiptarët nuk dëshojnë që mësimin i s

PËR ATË QË KËRKON PUNË TË PASTER

Ai kërkon punë të pastër, të rregullt
si fleta e bardhë e shkronjat e diplomës,
punëtorët mes shirave bukën e nxjerrin,
të tjerët mes pluhurit e tymit vjelin nëntokën.

Po si nuk i shikon ti vëllezërit
që larg në malësi u nisën?
Me më të madhen peshë të atdheut
majave më të larta shih si ngjiten.

Po si nuk i shikon duart e tyre
në qymyr, në krom përditë i rrabin,
me hekur e beton lartësojnë veprat,
qiellin e godasin me oxhakët...

Ndërsa fytyra e tij e shëndetshme, e bardhë
si bora që bie.
I vogël ky njeri aq sa dhe një flokëz
na e ze para syve.

Ai kërkon punë të pastër, të rregullt.
Nga shinat, nga transhetë mendimet e çiltra
kanë ardhur si shufra të skuqura,
t'i ngulen në kokë për t'i djegë mbeturinat.

V A L B O N È

Zili ta kanë lumenjtë pastërtinë,
o Valbonë, pasqyrë e këtij peisazhi.
Pasqyro tani dhe tufat e shpërthimit
si trëndafila gjigantë me petale shkëmbi.

Ushtojnë brigjet e tua, Valbonë,
nga shpërthimet kaq të mëdha.
Nga brigjet e tua gjer thellë në tokë
hyjnë minatorët me martel në krah.

Pasqyrë e këtij peisazhi je, Valbonë,
por shpirtin e pastër të njerëzve këtu,
ku ndeshen me shkëmbinjtë kokëfortë,
s'arrin ta pasqyrosh, jo kurrë...

1974.

BETONIM NË DIGË

MONDAY

Dritat e llampave këtu në digë
nëpër llaç e shufra hekuri përmbysen,
sikur mbillen para syve tanë këtu
në llampa të madhërishme nesër për të shpërthyer.

Betonojnë ata të dy pranë e pranë,
në këtë natë kaq të ndritshme,
muzgu i natës dikur binte kaq rëndë në këtë
si kujtimi i vëllavrasjes së prindërve.

Nata me atë kujtim griset,
nata që aq rëndë me ato ngjarje binte mbi digë,
nata me atë kujtim të hidhur të asaj kohe
qëndron e trembur nga ky konstelacion gjigant
yjesh.

Natë betonimi,
të dy pranë e pranë qëndrojnë,
dicka i ndante, zakon i shkruar,
por kjo natë dritash i bashkon.

ME DITARIN E ILIAS

Mësuesit Hero, Ilia Qiqi

Po vij ndryshe pranë jush sot, fëmijë,
me ditarin e Ilias shfletuar nga erërat.
Po vij nëpër shtigje, duke shkelur vetëtimat,
duke mbajtur gunën e rrreshjeve mbi shpatulla.

Po vij. Do t'ju sjell të mbani pak dhembje
nga ajo e fëmijëve të fshatit që e pritkan,
t'ju sjell një kurorë nga Dropulli me gjakun e
Llesh Palit
e një kurorë të bardhë drite nga Mati për Ilian.

Po vij unë sot, në gjoks rrugët e gjata,
shtigjet, erërat, peisazhet malore.
Sa i madh gjoksi, sa shumë mbaka,
sa e ngrohtë në të bota fëmijërore!

Po shkojmë nëpër atë rrugë që ece dhe ti,
pishtarin e dritës më lart për ta çuar.
Ditari i Ilias shkruar me jetën e tij
para tryezës sonë gjithnjë i shfletuar.

1975.

PSE FËMIJËT DOLËN NGA LUMI

Ata ishin mjaft tē gëzuar,
lumin me atë pellg kishin ndalur
t'i thithnin freskinë
që e sillte ai nga malet.

Në breg u dogja nga vapa.
Spirancën e zyrtarizmit preva,
në lumë u hodha,
pranë tyre
fëmijninë time sikur ndjeva.

Po pse pas atij sinjali që dha
njéri nga djemtë:
«Mësuesi po lahet, kujdes!»
të tërë dolën në breg?..

Pikla tē mëdha djerse
gushti vë në ballin tim tē thekur, tē nxirë,
po në marrëdhëniet me nxënësit e mi
ende kokrra akulli tē pashkrirë.

Dhe unë në breg, e përsëri në ujë,
së bashku me ta do të loz,
autoritetin fals si copëra dallgësh
në këtë lumë do ta copëtoj.

RRUGË E BARDHË DRITE

Për mësuesin e shkollës fillore M. A.

Kemi ardhur në shtëpinë tënde për vizitë.
Ti na mban mend me ato çantat e vogla,
megjithëse ne sot burra të ngarkuar
me peshën e madhe të ditëve tona.

Shtëpia jote në këtë qytet të madh
si klasa e atëhershme na duket;
kujtesën në çast të ankorojmë
në bregun e viteve të pasluftës.

Ne uleshim në bankat e vogla,
skuqeshim kur ngatërrroheshim në lexim a
mbledhje,
s'qeshte njeri pse mësimin na ndërpriste
mumullimë e lopës a blegrim' e deles.

Me sy fëmije si atëherë vështrojmë
para shkollës te kumbulla e lulëzuar
kreshtën e Gjalicës si jele kali e zgjatur
ku dielli në mbrëmje qendronte shaluar.

*
* *

Përzihen vegimet e asaj kohe në këtë dhomë.
Kujton: me sa ngrohtësi fshatarët t'rrethuan,
por pati dhe nga ata që n'qoshe e kthesa rrugësh
të të ngrinin kurthe nuk pushuan.

I shkrehëm disa dhe ne fëmijët
me pjekurinë tonë të parakohshme,
në botën tonë shkronjat dhe numrat
hynin të ngjyera me barotin e luftës klasore.

S'u mposhte nga presionet, kurthet,
që të ngrinte armiku i klasës;
dhe kur buka, ushqimi të mungonte
ngopeshe me gëzimin e fëmijëve të varfër.

* * *

Kemi ardhur jo me çantat e vogla si dikur,
me fletoret ku na pate vënë korrigjime.
Shumë nga ato i kemi ndrecurr
dhe me shkollën e jetës gjatë këtyre viteve.

Por merita juaj gjithnjë mbetet
se na mësove shkronjat që ka gjuha jonë.
Ato shkronja i kemi derdhur si gjerdan drite
në horizontin e mendimit tonë.

I kemi vënë ato në projekte,
në veprat kulturore dhe të ujites,
në shtëpitë e reja të fshatit si qytet,
në tregimet e vëllimet poetike.

Puna jote e palodhur në fshat
gjurmë e pashlyer për ne mbeti,
gjurmë që s'e mbulojnë vitet e që na drejton
të vijmë të të gjejmë gjer këtu në qytet.

Ja shtëpia jote si klasë e vogël por e ngrohtë
ku mblidhen kujtimet e atyre viteve,
rrugë e vështirë mes reve të kohës,
por rrugë e bardhë drite.

ANVON

NJË LUMË MES KATËR FSHATRAVE¹⁾

E sa shumë ngjarje
lidhen me emrin Tërkuzë,
po s'dimë pse këtë emër
të parët tanë i vunë.

Brente arat në luginë,
i gërryente pa mëshirë,
siç gërryente tërkuza nënët
në supe e në shpinë.

Me tërkuzë këtu fshatarët
mbi kurri pyllin kanë mbajtë,
e shpinin në kryeqytet
ta shkëmbenin me një kafshatë.

1) Është fjala për fshatrat: Zall Herr, Pinar, Herraj dhe Priskë e Vogël (rrethi Tiranës) që ndanë ky lumë. Sot këto fshatra përbëjnë një kooperativë bujqësore.

Rrjedh ky lumë si vargjet
e një poeme të gjatë,
e djeshmjë dhe e sotmja
kaq afër e kaq larg.

*

* * *

Katër fshatra ai ndante
me rrjedhën e tmerrshme,
këtu ku sa kokrra e misrit
peshontejeta e njerëzve.

Katër fshatra ndante
si katër akte tragjedie.
Sa jetë kjo tërkuzë ka gërryer,
sa jetë ka rrëmbyer!

Pranë disa shkëmbinje
rruga pritet nga lumi,
rrjedha e tij kish flakur
atë urë të vogël druri.

Veç gomari iu kthye
me një trajse në samar,
tërkuzat e lëshuara
me ujë ishin lagë.

E sa kushtuan kotheret
në trajsën me lëkurë dhie,
jo një barrë dru që shiti,
por një jetë fëmije.

E nëna e shkretë kërkonte
valët djalin ku e shpunë.
Valët dhe mbi ballë
e rrihnin si tërkuzë.

Por në gjoksin e kësaj nëne
këta shkëmbinj ndaluan
e në sytë e saj të mëdhenj
kjo rrjedhë e papushuar.

*

* * *

Si vitet e ngjarjet
rroddhi dhe ky lumë,
dikur aq i ashpër,
sot i butë, i butë.

Rridhte dikur me hidhërim,
ishte hendek i ndarjeve,
mbushur tejpërtej
me gjakun e vëllavrasjeve.

I ndante ai dikur
katër fshatra me vrasje,
fryhej me lotin e nënave,
me grindjet e hakmarrjet.

Po shtrati i tij gjëmoi
nga krismat e luftës,
shtegun e lirisë këtu
e çau grykë e pushkës.

Kudo i shoh, Parti,
frytet e veprës sate.
Mes njëri-tjetrit dje ishim si hasëm,
sot si bijë të një nëne.



S'qe lehtë që këto fshatra
të bëheshin kooperativë,
armiku i klasës vrapoi
kudo të vinte minë.

Me ty, Parti, në ballë
sa suksese arritëm,
brezat e fushës këtu
dhe në mal i ngjitëm!

Lumit kryeneçësinë
ia ulëm para kallnjve,
krahët e bruztë, të gjatë,
gjer në kodra t'i shtrinte.

Që mes gurëve e ranishtes,
mbi ferra dhe shkurre,
sot të tunden buqetat
e misrave dhe grunjave.

Dhe ndaj armikut të klasës
s'e pushojmë kurrë luftën,
muskujt një me kazmën,
syri në shënjestrën e pushkës.

E rritet zemra ime
e madhe sa kjo luginë,
ku tingujt e këngës
shoqëron me shushurimë.

*

*

*

Eh! Sa shumë ngjarje
lidhen me emrin türküzë,
jo më kot fshatarët
të tillë emër i vunë.

Ndante ai katër fshatra
si katër akte tragjedie,
sa jetë türkuza ka marrë,
sa tokë ky lumë pat rrëmbyer!

Në shkallën e Buvillës
një nënë me barrë ngarkuar
vdekja poshtë humnerës
e pati përgjuar.

Jehoi zëri i saj
në korridorin e Buvillës,
lumi zë funebër
iu bë me shushurimën.

Ja gruaja tjetër ngarkuar
nga peshë e rëndë dështoi,
tërkuza në fyt të saj
dy jetë me një lak rrëzoi.

*
* *

O nëna të dashura, mbi ju
sa shumë rëndoi tërkuza,
më dhëmbin motrat e shoqet
të shtypura, të vuajtura.

Më gjakosen dhe vargjet
nga plagët e vijave të saj,
vargu atë peshë stoicizmi
e ka vështirë ta mbajë.

Më dhëmbin gishtërinjtë tuaj
që nën tërkuzë i futët,
që prej peshës së drurëve
të mos i priste supet.

Me sytë tuaj e shikoj
këtë lumë mes luginës
si një türkuzë që me neveri
e flakët prej shpinës.

Ja, motra jonë e para
u ngjit mbi traktor,
prapanikët e besimtarët
syve s'iu besojnë.

Disqet e traktorit sot grijnë
si gramin e parcelës
dhe mendimet që türkuzës
donin t'i zgjasnin jetën.

* * *

Ardhka pranë lumit
buzëmbrëmja të pijë ujë,
dielli fshihka syrin
nën vetullën e purpurtë.

Ardhka këtu vajzë e re
me ankthin shtränguar,
buzë këtij lumi ka dalë
djalin për të takuar.

E s'pyet pse buzë lumit
kanuni dikur pat vrarë,
me tre plumba në zemër,
një dashuri, një vajzë.

*

* * *

Ecën lumi i qetë tani
krahët lart në kodër shtrirë
si krahët e katër fshatrave,
vëllezër në një kooperativë.

Vjen agimi buzë tij
dhe mes acarit të sertë,
buzë lumit qytezë e xhamtë
rrit domatet si në verë.

Derdhet agimi këtu
mbi shpërthim të pranverës,
ngre avullin e tokave
të përbysura për mbjellje.

I bukur éshtë
dhe katarakti i këtij lumi,
më i bukur nga makina shirëse
éshtë rrjedha e grurit.

Gjithnjë prodhimi lart
dhe mendimi i pastër rritet,
por fjalë e armikut si kuskuta
që rrreth bimës sillet.

Pëshpërit gjuhë e tij,
ujët e lumit s'ngrihet këtu,
buka s'bëhet në pyll
më mirë ta ruajmë për dru.

Pëshpërit gjuhë e rafinuar
në një qoshe rruge:
Si, një lloj si fusha e mali
të marri për ditë pune?

Veproi me detyrën e bariut,
thikë vu mbi tufën
e kërkoi të fsheh krimin
me gjurmat e ujkut.

Armiku i klasës zgjat dorën
zgjat edhe gjuhën,
në grykë kërkon përsëri
të na hedhë laku n e türkuzës.

*

* * *

Sa larg koha me kurrizet
e prera nga türkuzat,
tokat qarkuar me gjerdhe
si këmishat e arnuara!

Sa larg bota e fshatarëve,
bota e tyre e vogël,
me një tufë dele e dhi,
me një ngastër toke!

Në botën e tyre sot
hyjnë shqetësimet e kohës
me rendimentet e larta, grusht
bllokadës i bien kokës.

Diskutojnë: Më të mira
t'i kenë grunjat e misrat,
si të hyjë në çdo brigadë
përvoja e Këmishtajt!

Diskutojnë për çdo nen
të Projektkushtetutës,
si fishekët në armë
revolucioni u do bukën.

Më shumë do rrjedh ky lumë
në udhë e nëpër shtigje
zhurmëshumë e i ngarkuar
me peshë drithi e drite.

*
* * *

Jo, s'janë ato fytyra
me ankth të zbetë si hije,
kur kthehej me një kafshatë,
me një barrë dru shkëmbyer.

Jo, s'janë nënët e shkreta
me supet e gërryer nga tërkuzat,
që vetë hanin lakra
të miturve t'u delte buka.

Po janë nënët e gëzuara,
vajzat e djemtë e rinj,
blerimin e arave veshur
e me diellin plot në sy.

Nga makina po shkarkojnë
televizorin në një kuti.
Në shtëpinë e xha Elmazit
Shqipëria do të hyjë.

Ja, nënët e gëzuara
me fytyrat e qeshura,
në shtëpi nga drita e diellit
zgjeroi përmasat penxherja.

Pjatat, lugët, pirunjë
në raftin e kuzhinës,
për kujtim në qoshe çanaku
dhe kupa e drunjë e gjizës.

Vendimi i ri i Partisë¹⁾
në çdo shtëpi, në çdo zemër,
mes fshatit e qytetit
një afrim i ndjeshëm.

Lumë njerëzish nga qyteti
ngjiten drejt Zall Herrit
dhe lumi që i shikon
kërkon të ndërroj rrjedhën.

* * *

E sa shumë ngjarje
lidhen me emrin türkuzë,
legjenda gjithnjë e fsheh
emrin që të parët i vunë!

Gërryente arat në luginë,
gërryente pa mëshirë
si türkuza gratë e nënët
me peshë të rëndë në shpinë.

1) Vendimi i KQ PPSH dhe i KM të RPSH për uljen e pagave të larta, disa përmirësimë në pagat e punonjësve dhe ngushtimin e dallimit midis fshatit e qytetit.

Por sot ai ecën i qetë
nëpër shtratin e tij
dhe krahët e kaltër i shtrin
fushat e kodrat të ujisë.

Por s'qe lehtë ta bëje të qesh
për ne ky peisazh i bukur,
u desh gjak i lirisë të derdhej
e mos ftohej grykë e pushkës.

U desh të hynte socializmi
në çdo zemër e çdo brazdë,
që fjalë e shtrenjtë e Partisë
të ndrinte sytë e pastër.

Partia në udhëheqje,
Partia gjithnjë në krye,
sa gjak i ri në zemër,
sa horizont para syvel

Rrjedh gjithnjë ky lumë
rrjedhin edhe ditët
me peshën e rëndë të kohës,
me peshën e dritës, e drithit.

Hyn lumi i Tërkuzës
mes blerimit të të mbjellave,
me buzëqeshjen e njerëzve,
me shkëlqimin e pranverave.

*

* * *

Paralel me të zgjaten
llogoret dhe transhetë,
nevoja po e kërkoftë,
në lumë zjarri do t'i kthejmë.

Se presin gjithë armiqtë,
presin përtej kufijve,
presin dhe klerikët,
krimbat e xhamive.

Pret kulaku i vjetër,
pret armiku i klasës,
me sytë nga perëndimi
ëndërron «parajsën».

Presin përsëri
me zgjedhën e türkuzat,
ndaj të fort t'i kemi muskujt,
të mbushura pushkët.

Vigjilencia kurrë
të mos na zërë lagështi,
vigjilencia barot i thatë
dhe në tufan dhe në shi.

* * *

Ndodhet pranë Tiranës
lumi me emrin Tërkuzë,
dikur kaq i egër,
por sot i butë-butë.

Jo, s'po e krahasoj unë
me atë türkuzë të hequr
nga supet e nënave e grave
mes luginës së gjelbër.

Por me një shirit të kaltër
në mes të katër fshatrave,
që ngjyrën e bukurinë
i shton më shumë peisazhit.

Mbeti legjendë
emri i tij i ashpër.
E djeshmja dhe e sotmja
kaq larg, kaq afér!

1975-1976.

GLOBI NË LËVIZJE

1.

Rrotullohet globi në orbitën e progresit,
sjell ndryshimin e stinëve, e ditëve
dhe fitoret e reja të agimeve .

I përshkuar nga era e revolucionit
shtrëngon meridianet e pajimeve “
si ushtar në mësymje.

Globi ka larmi ngjyrash në relief,
larmi stinësh, politikash, ideologjish.
Ngjyra e atdheut tim, e socializmit
e kuqe,
të kuq flamujt e popujve në barrikadat e
lirisë.

M Marksizëm-leninizmi — diell që ndrit çdo shteg
në rrugën drejt fitoreve.

M Revolucioni — shpatë mbi padrejtësitë,
që i hap shtigje jetës e gjëzimit të popujve.

Ora e së ardhmes së ndritur të komunizmit

s'ndalet asnje çast,
fushë e saj praruar me ngjyrë rrezesh e gjaku

proletar>

akrep i saj — tyta e armëve,

tiktaku i saj — ritmi i zemrave të revolucionarëve]

2.

Rrotullohet globi rrëth boshtit të shqetësimit,
se atje ku janë në fuqi shfrytëzuesit

analite grataçielat lart shpojnë qiellin,

kolltuqet rriten për pasanikët të dhjamur nga
mbivlera

ndërsa nën gjilpërat e të ftohtit,

nën shiun e pikëpyetjeve ku do të punojnë nesër.

flenë miljona të varférj

C'do të hamë, ku do të punojmë?

Ku?

Pyetjet zgjaten.

Pikëpyetjet morën formën e grushtit.

Gjer kur punëtorët nën kërbaçin e padronit,
Si e kur negrit do të zgjatin jetën me mbeturina?
Humanizmi borgjez i spërkatur me gjak.
Nga Shtëpia e Bardhë e nga Kremlini
me shkopinj, armë e tanke dalka «drejtësia».

Borgjez,
ti barkun fryn me urinë e vdekjen e të varfërve,
fjalëve të tua s'u zë besë njerëzimi.
(Për ju dollari është më i shtrenjtë se fjala
ungjillore,
dashuri e shpresë keni mendimin për fitim¹.)

A s'i shitët ju interesat e popullin,
a nuk i vutë nën kërbaçë perandorësh e fashistësh,
kur u cënua sadopak interesи juaj.
Flet Spanja, Italia, Kili.

1) Vargje të poezisë — «I plagosuri në shtëpinë e miqve»
të U. Uitmanit.

Rreth boshtit të shqetësimit sillet globi
se i dhembin brinjët,
kur mbi brinjët e kurrizet e fëmijëve të varfër
spanjollë
bien shkopinjtë e atit Fridih¹⁾
e rrëqethet
për enkuplastet e Gutardit²⁾ mbi lëkurën e fëmijëve,
i dhembin viktimat nga tërmeti në Irian Gaja,³⁾
për familjet pa strehë që vdesin urie.

I dhembin globit brinjët
nën kërbaçin shovinist rusomadh,
i dhembin kockat Evropës Lindore
nga zinxhirët e tankut me emrin «Traktat».

3.

Rreth boshtit të shqetësimit,
rreth boshtit të gëzimit,
të sigurisë për të ardhmen,
shtyrë nga stuhitë e revolucionit,
ngrohur nga dielli komunist,
në orbitën e progresit rrotullohet globi.

1) prift spanjoll që torturon fëmijët në kolegj.

2) mjek që bën eksperimente në trupin e fëmijëve të varfër, duke rrezikuar shëndetin e tyre.

3) provincë në Indonezi

Luftërat e klasave thikë më thikë e të ashpra,
forcë shtytëse përpara, përpara!
Gjaku i martirëve spanjoll,
lumi Ebro, gjurmë gjaku
për t'u sulur në demonstratë.

Le të cirren Huan Karlosët,
Madriti, Barceelona, Valedovidi
gérthasin fort
«nos uniremos!»¹⁾

Sado të vazhdojë junta fashiste e Pinocetit në Kili
fushatën e terrorit,
terrorist veç benzinë do të hedhë
mbi zjarrin e luftës së popullit.

Bijtë e djersës,
masat punonjëse,
proletariati me trurin, zemrën e gjakun e vet,
partinë marksiste-leniniste,
më afër barrikadave,
më afër fitores, të drejtës e lirisë!

1) do të bashkohemi.

Kujdes, mos u gënjeni nga manovrat e ndryshme!
Qeveritë kuklla, të shitura,
thikat e vëllavrasjes mprehin
në grihen e diplomacisë së superfuqive!

Popujt s'po i gëlltisin profkat e tyre,
lirinë e vet po e gjejnë në folenë e fishekut
 të tytës,
me zjarr populli veriirlandez i përgjigjet
pushtetit shtypës.

Me zjarr populli palestinez
 fushatës së shkombëtarizimit,
me zjarr populli i Afrikës së Jugut
 regjimit racist të Rosterit.
Pa transhetë, pa luftën e armatosur,
pushteti si shtëpia që ngrihet mbi rërë,
 pa themele.

4.

Thonë se globin e mbaka boshti
që lidh dy superfuqitë,
por ky bosht po gërryhet nga erozioni i kontra-
diktave,

vetëm dy kafkat e krerëve
si dordolecë do të mbajë një ditë.

Kisingeri, Gromikua me dhëmbë të zhveshur,
pas tyre Fordi e Brezhnjevi kokë më kokë
vërtiten nëpër shtete
fijet e merimangës të shtrijnë nëpër botë.

Çdo gjë diskutojnë superfuqitë,
asgjë s'po zgjidhin,
litar i gjatë i politikës së tyre, si ai i kaut plak
rreth brirëve
që këmbët i ngatërron të bjerë!

Mbi tavolinën e të dy krerëve të superfuqive
uiski, vodka,
buzëqeshje, shqetësime, plane,
zbardhje e dhëmbëve të gllabërimit,
gjak i popujve nëpër buzë e gurmazë.

Globin vënkan përpara,
si portokalle s'e ndajnë.
Globi qenka i hekurt. R

Afrikë e Jugut në flakë,
Lindja e Mesme në flakë,
popujt e shtypur në këmbë,
goditje pas goditje për vdekje,
~~guvernat~~ e shteteve gjithnjë e më shumë
u shkulin spirancat e influencës.

5.

Globi është i yni!

L Globi është i kucq }

Me mendimin e Partisë sime
nga bedeni i lartë i kështjellës sime-mal
vështroj ngjarjet mbi glob,
superfuqive u them — Ndal!!!

Janë mbledhur në konferenca çarmatimi.

Gjeneralët në lëvizje,
nëpër harta shtetesh shtrikan vizat e sulmeve
si dhëmbëza tankesh,
maskuar me parullat e paqes e të çarmatimit.

Vigjilentë, shokë,
me Çekinë, Indonezinë dhe Kilin si tre shirita
të zinj
s'do të trembin popujt,
dhe nga humbjet — mësim,
vigjilencës mos t'ia ulim qerpikët asnje
grimë.

Pragë, të térheq veshin epoka.
Tradhtia t'i zuri sytë të mos e lexoje
vargun e Eluarit: «Praga fle gjumë, por sytë i
mban hapur,
tradhtia të zuri veshët të mos e dëgjoje
thirrjen e Fuçikut: Jini vigjilentë, njerëz!»
Nenet e traktatit të Varshavës,
lirisë iu ngulën si gozhdët.
Vargjeve të Majakovskit
«Monarkut t'ia thyejmë shpinën»,
kaq vargje poetësh modernë mbi shpinë i janë vënë,
por përsëri ato thirrje dëgjohen,
agimin e kuq do ta rindëzë Rusia,
ngjyrën e kuqe të globit do të rimarrë!

6.

e Globi është i kuq,
përflikur tejpërtej nga dielli komunist.
Borgjezëve imperialistë, socialimperialistë
spiralja e inflacionit u mbështillet fort pas trupit,

e i shtrëngon në grykë.

Rrëzohen qeveritë, presidentët

si kokrrat e krimbura.

Ekonomia e tyre qerre e dëmtuar nga pesha e rëndë

e militarizmit,

rrotat

kërcasin nëpër rrugët plot pengesa e gropë,

duke tërhequr aq shumë kapistrat

e të nënshtuarve

Shoqëritë e tyre të «konsumit»,

revolucioni tekniko shkencor,

KNERI

si kthethra bien mbi pavarësinë e shteteve.

Carët e rinj shtrijnë duart për drithë nga

perëndimi,

zgjasin rrjetat e hajdutit peshkatar gjer në brigjet

e Japonisë.

Me kthethrat e «Shoqërisë së përbashkët»

rrëmbejnë pasuritë natyrore të Mongolisë,

djersën e frytet e punës së bullgarit të shtrydhur...

Mbi ty sulen, o Afrikë,

me Saharën e shpirtit të tyre,

për t'u shpirë nga ngërç i krizave.

Afrika shtrëngon rubinetat e naftës,
shtrëngon në duar armët.
Mjaft me diplomacinë e tyre,
«as luftë, as paqe».

7.

„Rrotullohet globi,
ka shumë parazitë për të flakur,
shumë njolla pér të fshirë!

Njolla të zeza Uotergei.
Hullivudi në kazan poshtërsie përzien plane,
vrasje pas shpine.

Njollë e zezë — Kremlini,
buzë Sheshit të Kuq — shesh i poshtërsive, i
krimeve
të djemve gangsterë e të vajzave me minifunde.
Njolla të zeza — parqet, hipitë, holohupet...
ku vija e barazimit është vënë mes kafshëve dhe
njjerëzve.

8.

Në kuotën e krenarisë qëndroj,
me syrin në shënjestër vështroj

ngjarjet mbi glob.

Vashingtoni, Kremlini trazojnë kazanin
e ideologjive
me helm për popujt,
popujt kërkojnë të gënjejnë.

Në guvernaturë të ankorojnë influencën e vet,
të shtrijnë politikën, ekonominë, grabitjen
me kërcënime, me buzëqeshje, me ndihmën
hipokrite.

Idetë e Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit,
zëri i fuqishëm i Partisë sime,
i gjithë partive marksiste-leniniste në botë,
orienton popujt.

Mos u gënjeni,
armët mos i lëshoni,
liria sigurinë e ka veç në tytën e pushkës!

Në revolucion popujt!
M Revolucioni do ta djeg papunësinë
nëpër furnalta,
do ta groposë
nëpër brazdat e tokave të përbashkëta.

(**R**rotullohet globi
rrëth boshtit të shqetësimit,
rrëth boshtit të gjëzimit^{te} të optimizmit,
i përfshirë nga uragan i revolucionit,
M i përflakur nga diell i komunizmit.

Globi në lëvizje,
Kushtar në mësymje,
(shtrëngon meridianet si pajime,
fshin e flak kalbësirat e kohës,
rrit e gjallëron filizat
e së ardhmes së kuqe socialiste...

MOTIVE NGA KËMISHTAJ

	Faqe
1. Portreti yt	31
2. Mbrëmje në Këmishtaj	32
3. Dy rrepe mes fshatit	35
4. Kooperativistet e Këmishtajt	37
5. Mikpritje	39
6. Në sytë e tij	41
Trakti	43
Gishti i prerë	44
Fushat e betejës mban mbi shpinë	46
Lahe Rexhepja	47
Hape vallen	48
Bijë e Tragjasit, moj Zonjë	50
Mic Sokoli	51
Vjelëset e pambukut	53
Tekstilistet e kombinatit «Mao Ce Dun»	55
Peisazh dimri në fermë	56
Shefi i ri nga klasa	57
S'shuhet dashuria	59
Kritikë e rreptë në brigadën e blegtorisë	60
Duke shfletuar fletët e tokës	62
Prindërit	63
Ai mbet në përjetësi	65
Shpatullat të vuri malësia te këmbët	66
Po unë s'e meritoj kritikën?	68
Të erdhën mendt tani më në fund?	70

Faqe

Për atë që kërkon punë të pastër	71
Valbonë	73
Betonim në digë	74
Me ditarin e Ilias	75
Pse fëmijët dolën nga lumi	77
Rrugë e bardhë drite	79

POEMA

Një lumë mes katër fshatrave	85
Globi në lëvizje	103

BIBLIOTEKA
SHTETIT

85H-1
N 42

ISUF NE

Ditët -

VJERSHA DH

LAJ

tona

IE POEMA
